

Begatimi indirekt si figurë tipike e begatimit pa shkak

Prof. Asoc. Dr. Endirë Bushati

Abstrakti

Kodi Civil Shqiptar e rregullon institutin e begatimit pa shkak në Titullin VII të tij, nga nenet 655-658. Marrëdhëniet juridike që lindin nga begatimi pa shkak shfaqen të rralla në praktikën shqiptare dhe mbase kjo është dhe arsyeja që është shkruar pak për këtë institut. Në fakt, origjinën e padisë së begatimit pa shkak e gjejmë tek e drejta romake. Evolucionin e saj ka qenë i gjatë dhe i vështirë, derisa u arrit në ditët e sotme, ku shumë kodifikime aktuale kanë sanksionuar tashmë me kohë një parim të përgjithshëm. Kodifikimi i një parimi të përgjithshëm është në të njëjtën kohë një pikë mbërritjeje dhe pikë nisjeje. Një pikë mbërritjeje, sepse sanksionon evolucionin e gjatë, që duke filluar nga e drejta romake klasike, përmes asaj justiniane, të mesjetës, dhe në fund moderne, ka sjellë unifikimin e mjeteve të ndryshme në një padi të vetme, atë të begatimit. Njëkohësisht është dhe një pikë nisjeje, sepse të nesërmen e pranimit të një parimi të tillë nga kodifikimi modern (gjerman dhe italian), ai është thërmuar sërish në një seri hipotezash tipike, duke zbritur kështu, nga parimet e përgjithshme në figura të veçanta. Në doktrinën juridike, si një nga figurat e begatimit pa shkak trajtohet edhe figura e begatimit indirekt. Ky shkrim trajton begatimin indirekt si një nga rastet e begatimit pa shkak, kushtet e tij, duke analizuar këtë institut përmes vështrimit krahasues në sistemet e ndryshme të së drejtës.

Fjalë kyç: begatim, padi, dëm, send

Begatimi ex alieno contractu

Probleme të veçanta lindin kur begatimi rrjedh nga veprimet e të varfëruarit, p.sh. si në rastin e poseduesit të një toke, i cili ngarkon një sipërmarrës të ngrejë një ndërtime. Nëse të dy palët kontraktore i qëndrojnë besnik detyrimeve të tyre,

d.m.th. nëse sipërmarrësi e ndërton sendin e paluajtshëm dhe poseduesi derdh shumë e rënë dakord, nuk ka probleme të veçanta, të paktën për kontratat e sipërmarrjes. Megjithatë, mund të ndodhë që, pas ngritjes së ndërtesës, poseduesi i sendit të paluajtshëm të rezultojë insolvabël. Në këto raste, lind problemi të përcaktohet nëse kush ka kryer punimet, mund të veprojë ose jo me padinë e begatimit kundër pronarit të tokës për t'u rimbursuar në njëfarë mënyre për punimet e kryera. Në favor të këtij konkluzioni, natyrisht qëndron konsiderata, që nuk lejon atë që ka kryer punimet të përdorë padinë e begatimit kundër atij që ka përfituar në planin thelbësor, sepse do të përplasej pikërisht kundër parimit të përgjithshëm që ndalon të begatohesh pa shkak në dëm të një tjetri. Kundër kësaj, zakonisht konsiderohet që, të pranosh një mundësi të tillë të padisë direkte, do të përmbyste parimet në fushën kontraktore. Kush lidh një kontratë, e bën duke marrë parasysh rrezikun, duke vlerësuar rast pas rasti oportunitetin ose jo të lidhjes së kontratës. Në veçanti, paaftësia paguese e kontraktorit tjetër është një rrezik që bën pjesë tek rreziku normal i çdo kontrate. Çdo palë kontraktore, për vetë faktin që ka lidhur një kontratë, merr përsipër automatikisht një risk të tillë. Të pranosh një mundësi të padisë direkte në rastet e paaftësisë paguese të kontraktorit tjetër, do t'i atribuonte atij që ka kryer veprimin një pozicion të privilegjuar mes kreditorëve të personit të ndërmjetëm, në kontrast me parimin bazë të barazisë së pozicioneve të kredive (neni 531 i Kodit tonë Civil). Kësaj i shtohet edhe që, pranimi i mundësisë së atij që ka realizuar veprën ose kryer shërbimin, të veprojë direkt kundër përfituesit, mund të jetë në kontrast me parimin që askush nuk mund të detyrohet të paguajë për një send ose shërbim që nuk dëshirohet nga ai.

Kërkesat në lojë janë të shumëfishta dhe në kontrast me njëra tjetrën. Kjo, pjesërisht, shpjegon divergjencat e dukshme të zgjidhjeve të gjetura për këtë problem, sipas sistemit që merret në konsideratë. Tipike është në fakt, kundërshtia mes sistemit gjerman, ku një mundësi e tillë padie është rigorozisht e përjashtuar, dhe atij francez ku ajo anasjellas është pranuar, të paktën me fjalë me një gjerësi të madhe. Në këtë kuadër, vendet e *Common Law* natyrisht rrinë pranë Gjermanisë. Më pak e qartë është situata në Itali, ku jurisprudenca luhet mes dy zgjidhjeve. Në realitet, bëhet fjalë për një kundërshti më shumë në dukje sesa reale. Në planin operativ, shumë nga kundërshtitë që duket se shtrohen në një nivel konceptual, zbehen. Kësaj i shtohet edhe që, tani vonë, edhe në planin teorik, doktrina e sistemeve, në të cilat tradicionalisht përjashtohet një mundësi e tillë veprimi (Gjermani, vendet e *Common Law*), ka filluar pjesërisht ta rikonsiderojë çështjen, duke uruar një hapje më të madhe dhe fleksibilitet të jurisprudencës ndaj kërkesave të praktikës. Një fenomen i tillë, me kalimin e kohës do të çojë tek një përputhje gjithmonë e më të madhe të zgjidhjeve operative.

Rastet e ndryshme të begatimit indirekt

Sistemi në të cilin pranohet me gjerësi më të madhe mundësia e padisë së begatimit në rastet e këtij lloji është sigurisht ai francez. Jurisprudenca franceze, kur arriti të shpallte një parim të përgjithshëm që ndalon të begatolesh pa shkak në dëm të një tjetri, kishte si pikë referimi pikërisht një rast begatimi indirekt. Kjo ka ndodhur me vendimin e njohur të Gjykatës franceze të Kasacionit të 1892, ku qiramarrësi i një toke kishte blerë dhe më pas shpërndarë në tokë një sasi plehu. Pak kohë më pas ai u bë insolvabël, kontrata e qirasë arriti në fund, dhe ai nuk qe në gjendje as të paguante më furnizuesin e plehut. Ky i fundit mendoi të përdorte padinë e begatimit kundër pronarit të tokës, duke pretenduar që pikërisht ky kishte nxjerrë avantazh pa shkak nga shërbimet e tij. Gjykata e Kasacionit e zgjidhi konfliktin në favor të furnizuesit të plehut, duke shpallur parimin e përgjithshëm që kushdo që begatohet pa shkak në dëm të një tjetri është subjekt për një detyrim për kthim. Megjithatë, ky vendim nuk përfaqësonte një risi, të paktën në planin thelbësor. Që më përpara, jurisprudenca franceze e kishte të zakonshme të jepte shpërblim edhe në rastet e begatimit të ashtuquajtur indirekt, duke zbatuar padinë e gjerimit të punëve të tjetrit. Merita kryesore e këtij vendimi konsiston në atë që, solli në dritë atë që më përpara operonte në nivel të fshehur tek instituti i gjerimit të punëve të tjetrit. Ndërkohë, mospërputhja dallohet qartë. Ndërkohë që, jurisprudenca franceze ishte shumë e ashpër në përjashtimin e çdo mundësie për shpërblim për qiramarrësin që i bënte përmirësime sendit të marrë me qira, falë kësaj shpalljeje sanksionohej anasjellas, e drejta e atij që kishte kryer konkretisht shërbimin për llogari të personit të ndërmjetëm, për t'u rimbursuar nga pronari. Mospërputhja në fund u eliminua që kur, falë normave legjislative, iu njoh shprehimisht edhe qiramarrësve e drejta për t'u rimbursuar për përmirësimet e sjella.

Ky vendim nuk shtronte kufizime të veçanta, por kufizohej të sanksiononte parimin e përgjithshëm që kushdo që ishte begatuar pa shkak në dëm të një tjetri, ishte i detyruar të kthente sa kishte marrë. Parimi, i kuptuar me një gjerësi të tillë mund të kishte krijuar jo pak probleme koordinimi me institutet e tjera të pranuar nga sistemi dhe të çonte në përmbysjen e gjithë sistemit. Megjithatë, duhej të kalonin rreth 20 vjet para se Kasacioni francez të fillonte të përcaktonte me saktësi më të madhe kufijtë dhe kriteret e ushtrimit të një padie të tillë. Në veçanti, Gjykata e Kasacionit, duke bërë të vetin mësimin e Aubry dhe Rau, formuloi parimin e subsidiaritetit të padisë së begatimit. Në bazë të një parimi të tillë, të kuptuar në mënyrë rigoroz nga francezët, mund të përdoret padia e begatimit vetëm kur nuk ka mundësi të tjera padie. Ky parim, natyrisht, reflekton efektet e veta edhe për mundësitë e padisë së begatimit në rastet e begatimit *ex alieno contractu*. Kush lidh

një kontratë, në rastet e mospërmbushjes së palës tjetër, disponon në fakt padinë kontraktore, me pasojën që parimi i subsidiaritetit të padisë së begatimit duhej të kishte çuar tek përjashtimi total i mundësisë për padinë e begatimit në këto raste. Megjithatë, jurisprudenca e mëpasme doli në mënyrë brilante nga kjo rrugë pa krye, duke pranuar mundësinë e padisë së begatimit kundër përfituesit, vetëm në rastet kur padia kontraktore përballë direkt palës kontraktore kishte rezultuar e padobishme për shkak të paaftësisë paguese së saj.

Kështu, në bazë të këtij rregullimi, kufizimi i parë i mundësisë për të përdorur padinë e begatimit në këto raste, rrjedh nga kërkimi paraprak ligjor për palën kontraktuese. Vetëm në rastet e paaftësisë paguese, mund të vepohet gjyqësisht kundër përfituesit.

Një kufizim tjetër i rëndësishëm rrjedh nga parimet e përgjithshme, pra nga rrethana që mund të konfigurohet detyrimi për kthim vetëm nëse begatimi shfaqet i pajustificuar. Në veçanti, nuk mund të vepohet gjyqësisht kundër përfituesit, kur ky i ka paguar tashmë ndonjë shumë palës kontraktore, ose ka të drejtë në bazë të kontratës së lidhur me këtë të fundit, të bëjë përmirësimet e veta pa shumë. Mund të ndodhë që kontrata (p.sh. e qirasë) e lidhur mes të begatuarit dhe stipuluesit të rregullojë shprehimisht çështjen e përmirësimeve, duke i njohur pronarit të drejtën t'i bëjë të tija, pa korresponduar asgjë. Në të gjitha këto raste, në të cilat begatimi i titullarit të sendit e gjen justifikimin e vet në kontratën e lidhur me personin e ndërmjetëm, jurisprudenca është shumë konstante në përjashtimin e konfigurimit të detyrimit për kthim në favor të atij që ka kryer materialisht punimet. Në një vendim të 1939 është vendosur ky rast: një qiramarrës kishte lidhur një kontratë qiraje, në bazë të së cilës merrte përsipër detyrimin të kthente sendet në të njëjtën gjendje konservimi që ndodheshin në momentin e lidhjes së kontratës. Në vazhdim qiramarrësi, pikërisht për të përmbushur detyrimin e tij për të kthyer në skadim të kontratës sendet në gjendje të mirë konservimi, kishte lidhur kontrata të ndryshme për mirëmbajtjen e tyre. Me skadimin e afateve të kontratës, qiramarrësi rezultoi insolvabël, me pasojën që ata që kishin kryer veprimet e mirëmbajtjes vepuan gjyqësisht kundër pronarit të sendit për t'u shpërblyer të paktën në kufijtë e begatimit efektiv. Gjyqtarët nuk hezituan të vendosnin në favor të pronarit të sendeve, përse kohë ky i fundit, në bazë të kontratës së lidhur me qiramarrësin, kishte të drejtë të merrte kthimin e sendeve të veta në të njëjtën gjendje në të cilën gjendeshin në momentin e lidhjes së kontratës.

Në bazë të këtij rregullimi, për përjashtimin e detyrimit për kthim, mjafton që kontrata e lidhur mes pronarit të sendit dhe personit të ndërmjetëm të justifikojë në njëfarë mënyre kalimin pasuror. N.q.s. gjërat qëndrojnë kështu, rastet në të cilat konfigurohet detyrimi për kthim për begatim *ex alieno contractu*, janë të kufizuara, dhe në këtë sektor padia e begatimit ka fushë zbatimi shumë të ngushtë. Analiza e kazuistikës në fushën e begatimit indirekt, evidenton në fakt që, rastet e vetme

në të cilat shtrohet konkretisht një çështje e begatimit pa shkak, reduktohen në dy hipoteza bazë shumë mirë të përcaktuara. Grupi i rasteve më të rëndësishme është ai që lidhet me përmirësimet e tërthorta të një sendi të tjetrit. Skema tipike është ajo e një poseduesi, nuk ka rëndësi me çfarë titulli, të një sendi për më tepër të paluajshëm, i cili ka ngarkuar persona të tretë të kryejë punime mirëmbajtje, riparime, ose madje ndërtime mbi sendin në fjalë. Pranë këtyre rasteve mbizotëruese, kujtohen edhe disa vendime, në të cilat shërbimi i rënë dakord nga personi i ndërmjetëm nuk i referohet një sendi, por një personi tjetër. Kujtohen disa vendime që lidhen me mësues që kishin marrë përsipër detyrimin ndaj prindërve për të mësuar fëmijët e tyre, dhe që pastaj, të papaguar nga prindërit, kishin paditur me sukses vetë nxënësit. Pranë tyre mund të kujtohen disa vendime të tjera akoma më të vjetra, të lidhur me të ashtuquajturin zëvendësim ushtarak. Bëhej fjalë për kontrata, në bazë të të cilave një i tretë (normalisht babai) i premtonte një shumë parash një personi tjetër që të kryente shërbimin ushtarak në vend të një të riu. Mund të ndodhte që kush kishte premtuar shumën e parasë, nuk mundej më pas ta paguante. Në këto raste, jurisprudenca nuk ka hezitur kurrë të njohë mundësinë e veprimt gjyqësive direkt kundër atij që kishte përfituar nga zëvendësimi.¹

Kështu, rastet e vetme kur shtrohet konkretisht problemi i begatimit *ex alieno contractu* reduktohen në dy hipoteza bazë të dallueshme: hipoteza më e ndeshur është ajo e përmirësimeve të sendit të tjetrit. Këtyre rasteve u shtohen ato që mund t'i rendisim tek kategoria e kontratave në favor të të tretëve².

Është e qartë që rastet e vetme në të cilat mund të shtrohet një problem për kthimin, janë ato në të cilat, kontrata që konkretisht i ka sjellë përfitim të tretit kishte qëllimin për të përmirësuar sendin që i takon të tretit ose t'i sjellë një fitim të natyrës personale. Ky kufizim duket i qartë sapo marrim në konsideratë që në jetën e përditshme mund të ndodhë shpesh që një person, duke përmbushur një kontratë, i sjell dobi në mënyrë indirekte një të treti, si p.sh. një sipërmarrës që ngarkohet nga pronari i një toke bregdetare të ngrejë barrierë mbrojtëse kundër përmytjeve dhe ngritja e barrierës t'i japë avantazh jo vetëm pronarit të tokës, por edhe atyre të tokave përreth. Megjithatë, duket qartë si edhe në rastet, në të cilat kush ka realizuar veprën nuk arrin të paguhet për shkak të paaftësisë paguese të atij që i ka ngarkuar detyrën, këta nuk mund të veprojnë gjyqësive kundër pronarëve

¹ Jacques Ghestin, *Le contrat*, Paris 1980, f. 501

² Kontrata në dobi të një të treti rregullohet nga nenet 694-695 të Kodit tonë Civil. Kështu parashikohet që: "Kontrata në dobi të një personi të tretë është e vlefshme kur personi që e lidh ka interes për atë. Personi që ka pranuar premtimin në dobi të të tretit ose ky i fundit, apo personat që heqin të drejta prej tij, kanë të drejtë të kërkojnë zbatimin e kontratës, përveç kur ka marrëveshje tjetër. Kontrata nuk mund të prishet ose të ndryshohet pas momentit që personi i tretë ka deklaruar se pranon të përfitojë nga lidhja e saj, përveç kur propozuesi e ka rezervuar këtë të drejtë. Në rast revokimi të lidhjes së kontratës, ose të refuzimit të personit të tretë për të përfituar prej saj, detyrimi mbetet në dobi të propozuesit, përveç kur rezulton ndryshe nga vullneti i palëve ose nga natyra e kontratës. Pala që ka bërë premtimin në dobi të personit të tretë, mund t'i kundërvijë këtij prapsimit që rrjedhin nga kontrata, por jo ato që rrjedhin nga marrëdhëniet me palën tjetër."

të tjerë eventualë të avantazhuar në mënyrë indirekte nga puna e tij. Nuk shkakton habi kur mësojmë që në vendimet e pakta në të cilat jurisprudenca ka diskutuar një problem të tillë, ka arritur gjithmonë të mohojë detyrimin për kthim. Ky qëndrim nuk habit, përse kohë dimë që sistemi juridik nuk mund të marrë në konsideratë edhe efektet indirekte të sjelljes tonë në favor të të tretëve (*windfall*).

N.q.s. gjërat paraqiten kështu, shtrohet një tjetër konsideratë. Nëse rastet e vetme, në të cilat konkretisht shtrohet çështja e begatimit *ex alieno contractu*, reduktohen në rastet në të cilat kontrata është specifikisht e finalizuar për të përmirësuar një send të tjetrit, ose t'u japë të tjerëve ndonjë avantazh të natyrës personale, mund të pyetet nëse ka kuptim të ndërtohet një kategori specifike për rastet e begatimit indirekt. Në fakt, duhet pyetur nëse për këtë qëllim, nuk mjafton që, në rastet e përmirësimit të sendit të tjetrit, të bëhet referim tek parimet mbi padinë zëvendësuese, pra të pranohet që, kush ka kryer konkretisht punimet, mund të zëvendësohet në të drejtat eventuale të personit të ndërmjetëm ndaj titullarit të sendit³.

Përse i takon grupit të dytë të hipotezave, pra rasteve kur kontrata ishte finalizuar specifikisht për t'i sjellë të tretit një avantazh të natyrës personale, mund të zbatohen parimet në fushën e pagimit të padetyruar, në bazë të të cilave kushdo që ka përmbushur një kontratë, mund të kërkojë kthimin e objektit, ose, kur kjo nuk është e mundur, të pretendojë ndonjë formë pagimi për shërbimet e kryera. Në të gjitha sistemet e konsideruara, mospërmbushja e kontratës sjell në fakt një problem të pagimit të padetyruar nëse pala tjetër ka tashmë përmbushur detyrimet e veta. Ndërkohë, zgjidhja e kontratës për mospërmbushje, i jep të drejtë, sipas rasteve, të pretendohet si shpërblimi i dëmeve, si thjesht kthimi i asaj që është dorëzuar pa shkak. Komplikimi i vetëm i dukshëm i pranishëm në rastet kur është kryer diçka në favor të një të treti, rrjedhin nga ndarja e personave të kontraktuesit dhe të përfituesit. Kjo, gjithsesi, nuk mund të konsiderohet një arsye e mjaftueshme për të penguar veprimin e parimeve në fushën e pagimit të padetyruar. Ka autorë⁴ që dyshojnë rreth dobisë së krijimit të një kategorie në vetvete për të klasifikuar rastet e begatimit *ex alieno contractu*. Pjesa më e madhe e rasteve të pakta në të cilat konkretisht mund të shtrohet një çështje e begatimit indirekt, mund të zgjidhen në mënyrë efikase, duke bërë referim si tek parimet në fushën e zëvendësimit dhe kalimit të kredisë⁵, si tek rregullat mbi kërkimin e asaj që është dhënë e padetyruar.

Sistemi që paraqet më shumë ngjashmëri me atë francez është sigurisht ai italian. Në fushën e begatimit indirekt, situata në Itali është gjithsesi shumë më konfuze sesa në të drejtën franceze. Që nga kodi i 1865, mund të gjendeshin vendime si në favor, ashtu dhe kundër për një padi të tillë, edhe pse pjesa më e madhe e shpalljeve dukej se ishte kundër.

³ Neni 2900 KCI, F. Astone, *L'arricchimento senza causa*.

⁴ P. Gallo, F. Astone, etj

⁵ Nenet 496-507 KCSH

Me kodin e ri, situata u turbullua më shumë. Jurisprudenca është treguar sërish strikte, duke mohuar në raste të ndryshme çdo mundësi të padisë. Megjithatë, numri i vendimeve italiane në këtë fushë është i pakët. Nga leximi i atyre pak vendimeve, të cilat kanë mohuar detyrimin për kthim në rastet e begatimit indirekt, lind në fakt dyshimi që *ratio decidendi* e këtyre vendimeve duhet të kërkohet në vend tjetër.

Nën këtë vështrim, i rëndësishëm duket një vendim i Gjykatës së Napolit në 1982, që ka vendosur këtë rast: një qiramarrës kishte bërë të kryheshin punime të ndryshme ristrukturimi mbi sendin e paluajtshëm të marrë me qira. Më pas, për shkak të paftësisë pagueuse të qiramarrësit, kush kishte kryer punimet, kishte vepruar gjyqësisht kundër pronarit, por gjyqtarët e Gjykatës së Napolit vendosën në favor të këtij të fundit. Nga arsyetimi i vendimit duket qartë që arsyet e vërteta duhet të gjenden në një dispozitë specifike të ligjit të dikutuar në fushën e qirasë, e cila i mohon vetë qiramarrësit mundësinë që të paraqesë ndonjë pretendim për përmirësimet e bëra sendit (neni 1592 KCI)⁶. N.q.s. gjërat qëndrojnë kështu, *ratio* efektive e vendimit në fjalë duket e evidente: nëse legjislatori, për të mbrojtur qiradhënësin kundër rrezikut të vendosjes së përgjegjësisë nga begatimi, ka përjashtuar mundësinë për vetë qiramarrësin që të paraqesë ndonjë pretendim për kthim për përmirësimet e kryera pa konsensusin e qiradhënësit, po kështu do të duhet të përjashtohet që të tretë eventualë, të cilët materialisht kanë kryer punime për llogari të qiramarrësit mund të veprojnë kundër qiradhënësit. Është e qartë se si motivet e vërteta që qëndrojnë në bazë të këtij vendimi janë shumë të ndryshme nga ato që mund të shfaqen në pamje të parë, dhe se si mohimi i mbrojtjes nga ana e gjyqtarëve i detyrohet për më tepër praninë së një dispozite specifike të ligjit, e cila i përjashton vetë qiramarrësit mundësinë për të paraqitur pretendime për kthim për përmirësimet e bëra sendit. Në fakt, nuk duhet lënë pas dore që çështja e begatimit indirekt rezulton më tej e komplikuar nga problemi për të shmangur vendosjen e përgjegjësisë nga begatimi. Edhe kur është e mundshme të veprohet gjyqësisht në rastet e begatimit *ex alieno contractu*, një zgjidhje e tillë duhet në çdo rast të koordinohet me parimet në fushën e begatimit të detyruar, gjë që d.m.th. në thelb, të kufizohen rastet kur një kontraktues mund të veprojë gjyqësisht kundër pronarit, vetëm në rastet kur mund të veprojë edhe ndaj personit të ndërmjetëm. Në rastin e mësipërm, gjyqtarët e Gjykatës së Napolit kanë arritur t'u mohojnë atyre që materialisht kishin kryer punimet mundësinë për të vepruar gjyqësisht kundër titullarit të sendit të përmirësuar. Në këtë rast as qiramarrësi nuk do të kishte mundur në fakt të paraqiste ndonjë pretendim për përmirësimet. Pra, një

⁶ Neni 816 i KCSH parashikon që përveç kur parashikohet ndryshe në ligj, qiramarrësi nuk ka të drejtë të shpërblehet për përmirësimet e sendit. Në qoftë se ka patur pëlqimin e qiradhënësit, ky është i detyruar t'i paguajë një kompensim që i korrespondon shumë më të vogël midis shumëve të shpenzimeve dhe vlefës së rezultatit të dobishëm në kohën e dorëzimit. Kur qiramarrësi nuk ka të drejtë kompensimi, vlefëta e përmirësimeve mund të kompensojë dëmtimet që kanë ndodhur për pakujdesinë e rëndë të qiramarrësit.

komplikim i mëtejshëm konsiston tek nevoja për të pasur parasysh edhe parimet në fushën e begatimit të detyruar.

Në Gjermani, para daljes së BGB, jurisprudenca ishte treguar e moderuar në favor të pranimit të mundësisë për të vepruar gjyqësisht në rastet e begatimit indirekt. Kujtohen disa vendime që lidhen me raste në të cilat, për shkak të paftësisë pagueuse të kontraktuesit, ishte vepruar me sukses në gjyq kundër familjarëve të ngushtë që kishin përfituar nga ekzekutimi. Pas daljes së BGB, *Reichgericht* e ka ndryshuar qëndrimin.

Duke argumentuar nga shprehja *auf dessen Kosten* e adoptuar nga neni 812 BGB, është arritur në fakt në konkluzionin që, mund të shtrohet problemi i begatimit vetëm kur ka një lidhje shkakësore direkte mes begatimit dhe varfërimit. Për të sqaruar konceptin, kërkohet që begatimi dhe pakësimi korrelativ pasuror të ëonin tek i njëjti fakt gjenerues. Gjithsesi, rastet në të cilat nuk mund të paraqiten pretendime për kthim, pavarësisht të faktit të vetëm prodhues të begatimit dhe të varfërimit janë në fakt të shumta, si p.sh. një vendim qeverie që rrit taksat e importit të prodhimeve të caktuara, që sigurisht përket në humbje pasurore të importuesve të prodhimeve në fjalë në avantazh të prodhuesve të brendshëm ose një shoqëri publicitare që bën reklamë për të rritur konsumin e prodhimeve të caktuara, gjë që do të sjellë rritje të shitjeve të prodhimeve në fjalë në dëm të atyre të konkurruesve. Por edhe në këto raste është e qartë që, pavarësisht të të njëjtit fakt prodhues të dëmit dhe të begatimit, nuk mund të paraqiten pretendime për kthim. E vërtetë është që, në të gjitha këto raste nuk shtrohet një problem i begatimit pa shkak thjesht, sepse mungon një nga cilido faktorët që konsiderohen të përshtatshëm për të lindur një përgjegjësi të tillë, d.m.th. ndërhyrja në një situatë të mbrojtur të tjetrit, vullnetin për t'u detyruar, mirëbesimin e të varfëruarit e kështu me radhë. Teoria e të njëjtit fakt prodhues, tashmë krejtësisht e braktisur edhe në Gjermani, vazhdon të mbahet parasysh nga jurisprudenca italiane edhe në vendimet më të fundit.

Në Gjermani, pas daljes së BGB, *Reichgericht*, mbi bazën e një konceptimi të tillë të faktit prodhues, e ndryshoi jurisprudencën e vet të mëparshme, duke mohuar sistematikisht padinë në rastet e begatimit *ex alieno contractu*. Një tjetër argument që rëndonte peshoren në këtë drejtim, mbase gjendet në parashikimin e shprehur nga ana e BGB, së mundësisë për të vepruar kundër të tretëve eventualë vetëm në rastet e fitimit me titull falas⁷. Në këto dispozita shihet një shmangie nga parimi bazë i kalimit pasuror direkt (*Unmittelbarkeit*), dhe një konfirmim, në të kundërt, të pamundësisë për të vepruar në begatim në rastet e pasurimit *ex alieno contractu*. Jurisprudenca edhe e mëpasme i është përmbajtur parimisht një rregullimi të tillë, duke mohuar sistematikisht çdo mundësi në rastet e begatimit indirekt. Megjithatë, në Gjermani, ky rregull pëson disa përjashtime. Përjashtimi më i rëndësishëm i

⁷ Nenet 816, 822 BGB

referohet fitimeve me titull falas dhe është e sanksionuar nga vetë kodi (neni 822 BGB). Në kohët e para, ravijëzohej një tjetër përjashtim çdo herë kur mund të bëhej referim tek normat mbi shtimin. Në bazë të nenit 951 BGB, kushdo që ka humbur pronësinë e një sendi për shkak të shtimit, mund të paraqesë pretendime për kthim. Kjo normë në karakterin përgjithësues të saj, mund të zbatohet edhe në rastet e ndërtimeve ose të të mbjellave të kryera nga një i tretë në ekzekutim të një kontrate. Dhe në fakt kujtohen disa vendime në të cilat është konfiguruar një detyrim për kthim në favor të të tretit, pikërisht duke bërë referim tek parimet në fushën e shtimit. I rëndësishëm nën këtë këndvështrim shfaqet një vendim i 1900⁸, ku një i sëmure mendor kishte marrë me qira një send të paluajtshëm. Më pas kishte blerë një sasi patate për farë për t'i mbjellë në tokë. Për këtë, kishte arritur të merrte borxh nga shitësi i patateve, përmes të cilit do të siguronte punën e dorës të nevojshme për mbjelljen. I sëmuri mendor nuk arriti të përballonte detyrimet e veta, me pasojën që shitësi i patateve veproi gjyqësisht kundër pronarit të tokës. Gjyqtarët e zgjidhën çështjen duke konsideruar që, në vazhdim të veprimeve për farëzim pronësia e patateve ishte fituar nga pronari i tokës në zbatim të parimeve mbi shtimin. Gjithmonë në zbatim të këtyre parimeve, ata arritën në konkluzionin që shitësi i patateve kishte të drejtë të rimbursohet (neni 951 BGB). Ndërkohë që, i ndryshëm ishte konkluzioni përsa i përket borxhit të bërë nga shitësi i patateve, i cili kishte shërbyer për të paguar punën e dorës të nevojshme për të kryer mbjelljen. Edhe në këtë rast borxhi ishte kthyer sigurisht në avantazh të pronarit të tokës, megjithatë bëhej fjalë për një begatim të natyrës indirekte, me pasojën që, në mungesë të normës, nuk mund të konfigurohet detyrimi për kthim.

Në një rast tjetër (1912), një burrë kishte ndërtuar një furrë në shtëpinë e gruas së tij. Pas plotësimit të punimeve, burri rezultoi insolvabel. Kush kishte instaluar furrën veproi gjyqësisht kundër gruas, që në sajë të parimeve mbi shtimin ishte bërë pronare edhe e furrës, duke e fituar çështjen. Në bazë të këtyre vendimeve mund të paraqiteshin pretendime për kthim, çdo herë kur hynin në lojë normat mbi shtimin.

Megjithatë, para se kjo tendencë të konsolidohet më shumë, *Bundesgerichtshof* përjashtoi kategorikisht mundësinë për të bërë referim tek normat mbi shtimin, në rastet për ndonjë të drejtë shpërblimi në favor të të tretit kontraktues. Gjykata supreme theksoi në fakt parimin, në bazë të të cilit kushdo që ka kryer një punim, mund të paraqesë pretendime vetëm karshi personit për të cilin është kryer punimi.

Një përjashtim nga ndalimi i padisë direkte në rastet e begatimit *ex alieno contractu*, është pranuar në Gjermani në rastet e pjesëmarrjes në një krim. Kush ka marrë pjesë në një fakt kriminal, në çdo rast në fakt është i detyruar të kthejë atë që ka marrë, edhe n.q.s. e ka kryer përmes ndërmjetësimit të një personi tjetër.

Kështu, edhe në Gjermani ka raste, në të cilat konfigurohet detyrimi për kthim edhe pse kalimi pasuror rezulton tërthorazi nga pasuria e një personi tjetër. Duket

⁸ RGZ 51, 80

gjithsesi e qartë, përveç rastit të transferimeve falas, bëhet fjalë për hipoteza krejt dytësore, që nuk çenojnë parimin, në bazë të të cilit në Gjermani begatimi *ex alieno contractu* nuk i lë vend normalisht restitutionit.

Së fundmi, doktrina e ka ridiskutuar çështjen. Nga shumë autorë është konsideruar që rregulli që përjashton kthimin në rastet e begatimit indirekt është shprehje e një konceptimi të padisë së begatimit tashmë të superuar. Në veçanti, kërkesa për kalimin direkt të pasurisë, ishte zhvilluar në një periudhë në të cilën qëndronte akoma ideja që ushtrimi i padisë së begatimit presupozonte domosdoshmërisht një kalim pasuror (*Vermögensverschiebung*), dhe d.m.th. një transferim të pasurisë nga pasuria e të varfëruarit tek ajo e të begatuarit. Teoria e kalimit pasuror integrohej nga saktësimi që jo çdo kalim pasuror merrte rëndësi, por vetëm kalimet pasurore të ndodhura pa ndërhyrjen e pasurisë së një të tretit, mund të lindnin pretendime me natyrë dëmshpërbyese. Megjithatë, ky konceptim ka filluar të hyjë në krizë të thellë që kur kushtet u kuptuan me tolerancë më të madhe. Në veçanti, si në doktrinë dhe në jurisprudencë është tashmë e qartë që, padia e begatimit nuk presupozon domosdoshmërisht një kalim pasuror, e aq më pak një dëm eventual të subjektit pasiv. Por n.q.s. gjërat konceptohen në këtë mënyrë, d.m.th. nëse për ushtrimin e padisë së begatimit, nuk kërkohet si e domosdoshme prova e kalimit pasuror, për më shumë arsye nuk mund të marrë rëndësi as karakteri pak a shumë direkt i begatimit. Dhe është pikërisht ky arsyetimi i ndjekur nga shumë autorë gjermanë bashkohorë, të cilët kanë konstatuar se, duke rënë kërkesa e kalimit pasuror, dhe kështu, e korrelacionit mes dëmit e begatimit, është e destinuar të bjerë edhe kriteri i kalimit direkt. Sipas autorëve në fjalë, kështu do të ishte e hapur rruga edhe për refleksion për gjithë çështjen e begatimit *ex alieno contractu*. Megjithatë nuk njihen vendime që ta kenë tashmë pranuar një sugjerim të tillë.

Në *Common Law*, situata paraqitet e ngjashme me të drejtën gjermane. Si në Angli dhe në SHBA, jurisprudenca ka qenë gjithmonë shumë e vendosur në përjashtimin e çdo mundësie të padisë direkte në rastet e begatimit *ex alieno contractu*. Është e qartë që një *improver*, i cili ka vepruar sipas porosisë të qiramarrësit të një sendi të paluajtshëm, nuk mundet pastaj të paraqesë asnjë pretendim për kthim karshi pronarit të vetë sendit. Po kështu, kush ka kryer punime për llogari të fituesit të një sendi të paluajtshëm, nuk mund të paraqesë pretendime për kthim kundër shitësit, nëse kontrata e shitjes zgjidhet më pas. Në rastin e punimeve të kryera për llogari të poseduesit mbi një send të luajtshëm, kush ka kryer punimet nuk mund të paraqesë asnjë pretendim karshi pronarit.

Konkluzioni i vetëm i mundshëm është që, edhe në vendet e *Common Law*, nuk është e mundur të veprohet gjyqësisht në rastet e begatimit *ex alieno contractu*.⁹

Ky rezultat justifikohet në mënyra të ndryshme. Në bazë të sistemit kontraktor anglez, kontratat mund të kenë efekt vetëm mes palëve kontraktuese (*privity of contract*). Kur akoma mendohej që, quasi kontratat ishin kontrata implicite, koncepti

⁹ P. Birks, G. Virgo, etj

i *privity* ishte shtrirë edhe në këtë sektor. Rezultati praktik i këtij rregullimi ishte përjashtimi i mundësisë për konfigurimin e çdo lloj përgjegjësie të karakterit për kthim, kur nuk ishte në prani të një kalimi direkt të pasurisë mes palëve. Më vonë konceptimi i quasi kontratave si kontrata implicite hyri në krizë, me pasojën që gjyqtarët pushuan edhe së kujtuari për konceptin e *privity* për të mohuar përgjegjësinë në rastet e begatimit indirekt. Aktualisht arrihet i njëjti rezultat, duke përjashtuar thjesht e pastër që bëhet fjalë për një begatim të padrejtë. Edhe në vendet e *Common Law*, ky rregull pëson gjithsesi disa përjashtime: njëri është ai i avokatëve. Në *Common Law*, qëndron ideja që nëse një avokat në përmbushjen e një kontrate të lidhur me klientin e vet, u jep indirekt avantazh edhe personave të tjerë, mund të pretendojë të paguhet edhe nga këto. Megjithatë bëhet fjalë për një rregull krejtësisht përjashtimor, shprehje e një situatë privilegj nga e cila gëzojnë njerëzit e ligjit në vendet *Common Law* dhe pa shpjegim racional.

Në kohët e fundit, jurisprudenca ka treguar edhe hapje të tjera: kështu, p.sh. nëse pronari i një sendi të përmirësuar premton në një moment të mëpasëm të paguajë *improver-in*, ky i fundit mund të veprojë gjyqësisht për të pretenduar përmbushjen e premtimit, edhe pse ajo bazohet mbi një *past consideration*. Më pak e qartë është ndërkohë cila mund të jetë zgjidhja në rastin kur mungon një premtim i shprehur i pronarit të sendit për të kompensuar atë që ka kryer punimet. Sipas njërës prej ekspertëve më të mëdhenj të *restitution*, Dawson, mundet parimisht të pranohet konfigurimi i detyrimit për kthim edhe në rastet e mungesës së premtimit të shprehur, me kushtin që, ky të mos përkthehet në vendosjen e përgjegjësisë nga begatimi kundër vullnetit të pronarit të sendit. Në të gjitha rastet, në të cilat anasjellas, mund të gjendet ndonjë formë e “*consent*”, “*acceptance*” ose “*agency*”, sipas Dawson, nuk shtrohen probleme të veçanta në konfigurimin e mundësisë së një padie direkte.¹⁰ Në fakt, nuk mungojnë raste të rralla, tani për tani të izoluara, në të cilat jepet padia direkte ndaj përfituesit të fundit, me saktësimin që para se të veprojë me padinë e begatimit, është e nevojshme të ketë ezauruar çdo mjet që lind nga kontrata karshi kontraktuesit direkt, dhe që përfituesi në planin thelbësor të përmbushjes nuk i ka kaluar shumën personit të ndërmjetëm. Bëhet fjalë për vendime akoma të kufizuara në rastet, në të cilat përfituesi i fundit i detyrimit dhe personi i ndërmjetëm ishin në lidhje të afërta familjare.

Begatimi indirekt në raportet familjare

Rregulli i mësipërm pëson një përjashtim të madh në marrëdhëniet familjare. Në të gjitha sistemet e konsideruara është e qartë që, nëse dikush furnizon sende konsumi apo kryen një shërbim sipas ngarkimit të një familjari, mund të paraqesë

¹⁰ Indirect enrichment, Dawson, f. 342

pretendime për kthim edhe ndaj familjarëve të tjerë eventuale bashkëjetues, që në njëfarë mënyre kanë nxjerrë avantazh nga ekzekutimi. Fenomeni është në radhë të parë evident në *Common law*, ku pranohet që, nëse një grua bën porosi në kuadrin e administrimit familjar, burri mund të jetë i detyruar të paguajë për të, në rastin kur gruaja nuk i respekton personalisht detyrimet e marra përsipër. Pushteti i gruas për të detyruar burrin, normalisht justifikohet përmes drejtimit tek koncepti i përfaqësimit të heshtur që, për vetë faktin e martesës apo të bashkëjetesës, gruaja ka karshi të shoqit. Megjithatë, përgjegjësia e burrit është rigorozisht e ngushtë vetëm për *necessaries*, pra vetëm për sendet e konsumit (ushqimore, veshje), ngushtësisht të domosdoshme për kërkesat e jetës së përditshme, dhe duhet ndërkohë të bëhet fjalë për sende që nuk e kalojnë stilin e jetës dhe burimet e familjes në fjalë. Një pushtet i tillë përfaqësimi duket ndërkohë se lind edhe në rastet e bashkëjetesës, dhe nuk pushon as pas ndarjes eventuale të bashkëshortëve, në kuptimin që, burri, edhe para se të detyrohet formalisht nga gjyqtari për të furnizuar me ushqime të shoqen, është i detyruar t’u bëjë ballë detyrimeve të marra përsipër nga gruaja për kërkesat e saj të jetës së përditshme. Nuk njihen vendime në të cilat gruaja është detyruar të përballojë detyrime eventuale të marra përsipër nga burri. Sigurisht, bëhet fjalë për një pushtet shumë të ngushtë, të kufizuar vetëm për sendet e nevojës së parë.

E ngjashme paraqitet situata në Gjermani, ku fenomeni është shprehimisht i rregulluar nga kodi. Neni 1357 BGB sanksionon që çdo bashkëshort është i autorizuar të kryejë transaksione të arsyeshme për nevojat e jetës, me efektin që edhe bashkëshorti tjetër është i detyruar të paguajë. Kështu, edhe në Gjermani mundësia për furnitorët për të vepruar direkt kundër njërës bashkëshort, bazohet mbi pak a shumë një raport të prezumuar përfaqësimi të përfshirë në vetë bashkëjetesën martesore. Pyetja që shtrohet është se, pse legjislatori gjerman ka ndjerë nevojën të disiplinonjë specifkisht çështjen, edhe pse në prani të një parimi të përgjithshëm që ndalon të begatohesh pa shkak në dëm të një tjetri (neni 812 BGB). *Ratio* e kësaj norme duket lehtësisht e kuptueshme kur konsiderohet që referimi tek parimet normale në fushën e begatimit do të çonte tek përgjysmimi i përgjegjësisë së njërës bashkëshort. Sendet e blera nga njëri bashkëshort, prezumohen në fakt të konsumuara 50% nga secili bashkëshort.

E ngjashme paraqitet situata në Francë dhe Itali, ku ose përmes konceptit të mandatit të heshtur, ose atij të begatimit pa shkak, ose akoma atij të gjerimit të punëve, normalisht detyrohet burri për të përballuar detyrimet e marra përsipër nga gruaja.¹¹ Edhe në këto vende, ishte thelbësore që gruaja nuk ka marrë detyrime që kalojnë standardin normal të jetës së familjes. Në disa raste, parime të tilla janë zbatuar edhe në situata bashkëjetese të ndryshme nga ajo martesore. Në Francë, në një rast, është vendosur që një vëlla i cili bashkëjetonte me motrën nën të njëjtën

¹¹ Carbonnier, Droit civil, Bianca, Diritto civile, La responsabilita, etj

çati, ishte i detyruar të përballojë detyrimet e marra përsipër nga motra për nevojat e përbashkëta. Gjerësisht e pranuar është ndërkohë një mundësi e tillë padie edhe në rastet e bashkëjetesës *more uxorio*.¹² Në një rast të gjykuar në shekullin 19 në Itali, ishte vendosur që një padron që kishte konsumuar sende të blera nga shërbëtori i tij, ishte i detyruar përballë kreditorëve në kufijtë e begatimit.

Kujtohet dhe një rast në Itali në 1956, në të cilin disa mjekë, pasi shëruan djalin sipas porosisë nga babai, në pamundësinë për të marrë sa u takonte nga ky i fundit për shkak të paaftësisë paguese së tij, vepruan me sukses gjyqësisht me padi begatimi kundër nënës.

Tashmë, konform evolucionit të së drejtës moderne familjare, pozicioni i të dy bashkëshortëve është i barabartë.

Në Kodin tonë të Familjes¹³, parashikohet: *“Me martesë burri dhe gruaja përfitojnë të njëjtat të drejta dhe marrin përsipër të njëjtat detyrim. Nga martesa lind detyrimi reciprok për besnikëri, për ndihmë morale dhe materiale, për bashkëpunim në interes të familjes dhe të bashkëjetesës”*¹⁴. *Secili nga bashkëshortët mund të kryejë vetë, pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër, veprimet juridike që kanë të bëjnë me mbajtjen e familjes ose me edukimin e fëmijëve. Për detyrimet e marra përsipër nga njëri bashkëshort, detyrohet solidarisht edhe bashkëshorti tjetër. Përgjegjësia solidare nuk ka vend për shpenzimet haptazi të tepërta, duke pasur parasysh mënyrën e jetesës në familje, dobishmërinë e veprimit të kryer, si dhe mirëbesimin ose keqbesimin e personave të tretë kontraktues.*¹⁵

Jurisprudenca e sistemeve të ndryshme të konsideruara, e cila ose në zbatim të dispozitave specifike normative (neni 1357 BGB), ose në rrugë jurisprudenciale ka konfiguruar një të drejtë pak a shumë të gjerë të kreditorëve për t'u kënaqur edhe përballë familjarëve të tjerë eventuale që indirekt kanë nxjerrë avantazh nga veprimi i tyre, pavarësisht se në këto raste, nuk bëhet fjalë as për kontrata specifikeisht të finalizuara për të përmirësuar një send të të begatuarit, ose t'i sjellë një avantazh të natyrës personale, por bëhet fjalë për refleksë të thjeshta pozitive, indirekte, që pasojnë ekzekutimin e një kontrate të lidhur me persona të tjerë. Një zgjidhje e tillë duket se gjen justifikimin e vet në vetë realitetin familjar. Nëse dikush blen sende konsumi për përdorim të të gjithë familjes, ose merr me qira një apartament gjithmonë për të njëjtat qëllime, duket e drejtë që në rastet e paaftësisë paguese së kontraktuesit direkt, mund të futen në lojë edhe familjarët e tjerë që padyshim kanë nxjerrë avantazh nga kontrata¹⁶.

Një zgjidhje e tillë duket konform konceptimit unitar (edhe nën profilin ekonomik), të bërthamës familjare, natyrisht në kontrast me konceptimin

individualist të marrëdhënies së detyrimit, që parimisht i shtrin efektet në mënyrën më rigorozë të mundshme vetëm për kontraktuesit. Kjo zgjidhje duket më shumë konform një sistemi të përqendruar jo aq mbi individin dhe raportet e tij me të tjerët, por mbi grupin familjar, të kuptuar si bërthamë primare të trafikut juridik. Në një situatë të tillë ajo që ka rëndësi në raportet e jashtme nuk është aq individi, por grupi familjar. Cënimi i individit konsiderohet si një cënim i grupit, blerja e një sendi nga ana e një individi hyn automatikisht të bëjë pjesë tek pasuria familjare, e kështu me radhë. Sistemet moderne janë më tepër të krijuar për njeriun si individ dhe e drejta, në radhë të parë do të rregullojë raportet mes njerëzve vetëm dhe jo mes grupeve. Një konceptim i tillë është tashmë thellësisht i rrënjësuar në traditat juridike kryesore. Megjithatë, ajo nuk mund të konsiderohet gjithmonë e kënaqshme, si në rastet e mësipërme. Jo gjithmonë konceptimi mbizotërues i të drejtës të bazuar mbi raportet individuale, çon në rezultate krejt të kënaqshme, dhe disa herë është e nevojshme të gjenden rrugëdalje për të shmangur dogmën e relativitetit të efekteve kontraktuale. Kjo rrugë nuk është pa rreziqe. Në veçanti, pasi është pranuar përgjegjësia e pjesëtarëve të tjerë të bërthamës familjare për sende e nevojës së parë, duhet të sqarohet deri në cilën pikë një zgjidhje e tillë mund të konsiderohet e dëshirueshme, p.sh. në rastet blerjes së një makine apo të një shtëpie për jetën e përbashkët? Doktrina kontinentale përjashton përgjegjësinë e familjarëve të tjerë në lidhje me borxhe eventuale, kontrata për motive personale ose gjithsesi në lidhje me aktivitetin e vet personal, edhe pse një aktiviteti të tillë mund të kenë shkuar në avantazh të të gjithë familjes. Në praktikë, çështja shtrohet në terma shumë të kufizuar, përse kohë jurisprudenca e të gjitha sistemeve të marra në konsideratë, kufizon përgjegjësinë e familjarëve të tjerë vetëm për detyrimet që rrjedhin nga sende të nevojës së parë (*necessaries*) të blera për kërkesat e jetës së përbashkët.

Konkluzione

Rastet e vetme në të cilat konkretisht shtrohet një çështje e begatimit *ex alieno contractu* duket se reduktohen në pak hipoteza bazë; grupi i rasteve pa dyshim më të rëndësishëm përbëhet nga përmirësimet e tërthorta të sendi të tjetrit. Shembulli paradigmatic është një posedues ose mbajtës i një sendi, i cili bën të kryejë punime mirëmbajtje ose përmirësimi të sendit në fjalë. Në këto raste, lind çështja, nëse në rastet e paaftësisë paguese të personit të ndërmjetëm, kush ka kryer punimet mund të paraqesë ose jo pretendime për kthim direkt ndaj titullarit të sendit. Këtij grupi të parë hipotezash i shtohet një tjetër që lidhet me rastet, në të cilat dikush ka marrë përsipër detyrimin të kryejë diçka në favor të një personi tjetër ku, akoma dhe një herë çështja që lind është nëse kush ka kryer

¹² Lat. Si burrë e grua

¹³ Ligji nr.9062, datë 8.5.2003

¹⁴ Neni 50 KF

¹⁵ Neni 60KF

¹⁶ Në bazë të nenit 102 ZGB (Kodi Civil Zvicëran) qiramarrësi është i detyruar të paguajë qiranë. Neni 100 ZGB saktëson që qiramarrës janë të dy bashkëshortët edhe kur vetëm njëri ka lidhur kontratën.

atë që ka marrë përsipër, në rastet e paaftësisë paguese së kontraktuesit, mund të veprohet direkt kundër përfituesit. Kështu, është e qartë që rastet e vetme, në të cilat konkretisht shfaqet një çështje begatimi pa shkak, duket së reduktohen tek hipotezat, në të cilat kontrata është specifikisht e finalizuar për të përmirësuar një send të tretit, ose t'i sjellë përndryshe një avantazh të natyrës personale. Ky kufizim natyrisht nuk habit, përse kohë që ekzekutimi i shumë kontratave mund të reflektojë efekte pozitive në favor të personave të tjerë. Megjithatë, sistemi nuk mund të merret me këto efekte pozitive ose negative të sjelljes tonë. Ky rregull pëson një përjashtim shumë të madh përse i përket kontratave të lidhura nga një familjar për jetesën e përbashkët. Në të gjitha sistemet e marra në konsideratë, ekzistonte rregulli, në bazë të të cilit njëri bashkëshort (dikur më tepër burri), për më tepër në sajë të një raporti të heshtur përfaqësimi, mund të jetë i detyruar t'u bëjë ballë detyrimeve të marra përsipër nga bashkëshorti tjetër për sende të nevojës së parë.

Në qoftë se këto janë tre rastet e vetme, në të cilat konkretisht duket se mund të shtrohet çështja e begatimit *ex alieno contractu*, mbetet për të përballuar çështjen nëse në secilën prej këtyre tre rasteve bazë, është oportune apo jo t'i drejtohesh padisë së begatimit për të garantuar ndonjë formë shpërblimi.

Në hipotezën e parë të përmirësimit të tërthortë të sendeve të tjetrit, çështja e begatimit *ex alieno contractu* ndërhyt me atë të mbrojtjes së të begatuarit, kundër vendosjes së përgjegjësisë kundër vullnetit të tij, gjë që me fjalë të varfra do të thotë që, duke pranuar parimisht mundësinë e të varfëruarit për të vepruar direkt kundër përfituesit të veprimit, duhet të përjashtohet një mundësi e tillë ku, pikërisht për të shmangur fenomenin e begatimeve të detyruara, nuk do të mund të vepron as personi i ndërmjetëm. Duket po aq e qartë se, kush ka kryer materialisht punën, mundet të veprojë gjyqësisht kundër të begatuarit, vetëm në rastet në të cilat mund të veprojë edhe personi i ndërmjetëm. Pikërisht mbi bazën e këtyre konsideratave, shumë autorë kanë përjashtuar çdo mundësi padie direkte dhe sugjerojnë, anasjellas, mundësinë për autorin e përmirësimit të ushtrojë në rrugë zëvendësuese të drejtën që i takon personit të ndërmjetëm.

Një arsyetim i ngjashëm përsëritet edhe për dy hipotezat e tjera të begatimit *ex alieno contractu*. Në rastet kur kontrata është specifikisht e finalizuar t'i sjellë të tretit një avantazh të natyrës personale, duket logjike në radhë të parë të bëhet referim tek parimet e kërkesës për kthimin e asaj që është dhënë e padetyruar. Mosderdhja e shumë të rënë dakord, në fakt, plotëson kushtet e mospërbushjes, me pasojën që mund të veprohet gjyqësisht kundër përfituesit, për të marrë kthimin në natyrë sa është e mundur, ose pagimin e vlerës. Në këto raste, vështirësia e vetme e mundshme rrjedh nga ndarja e personit kontraktues dhe e përfituesit. Megjithatë nuk duket që një ndarje e tillë mund të pengojë në ndonjë mënyrë veprimin e parimeve mbi kthimin e pagimit të padetyruar.

Përse i takon hipotezës së fundit që lidhet me kontrata të bashkëshortit për jetesën familjare, sigurisht mjafton të konfirmohet praktika që tenton për më tepër t'i zgjidhë këto raste, duke konfiguruar një raport pak a shumë të prezumuar përfaqësimi të njërit bashkëshort karshi tjetrit.

Kështu, shumica e rasteve, në të cilat shtrohet çështja e begatimit indirekt, mund të zgjidhet në mënyrë brilante përmes drejtimit tek institute të tjera, pa futur në lojë padinë e përgjithshme të begatimit. Nëse situata shfaqet e tillë, mundet edhe të konkludohet duke adoptuar tezën më të ngushtë, e cila përjashton pikërisht ngritjen e padisë së begatimit në rastet e këtij lloji. Megjithatë, kjo zgjidhje nuk pranohet krejtësisht nga doktrina kontinentale. Është në fakt e vërtetë që, në shumicën e rasteve, të paktën në sistemin italian, tashmë mund të ketë shpërblim përmes drejtimit tek institute të tjera, megjithatë, kjo nuk shihet si një arsye e mjaftueshme për të përjashtuar mundësinë e padisë së begatimit, dhe kjo për disa arsye. Në radhë të parë, sepse jo në të gjitha sistemet janë domosdoshmërisht të pranishme institutet e ndryshme që konkretisht, lejojnë në Itali kompensimin e pamundësisë për të vepruar direkt me padinë e begatimit; në radhë të dytë, nëse është e vërtetë që në shumicën e rasteve është e mundur të arrihet shpërblimi pa padinë e begatimit, kjo nuk heq faktin që mund të jenë raste dytësore, në të cilat institutet e ndryshme në fjalë (zëvendësimi, pagimi i padetyruar përfaqësimi i heshtur) nuk mund të operojnë, me pasojën që përjashtimi edhe i mundësisë së padisë së begatimit, mund të sjellë krejtësisht një mohim mbrojtjeje, si p.sh. në rastin kur dikush konsumon sende të blera nga një tjetër, ose kur një qiramarrës eventuale, i cili nxjerr avantazh nga punë eventuale të kryera nga një qiramarrës i mëparshëm. Kjo është arsyeja pse shumë autorë nuk përjashtojnë mundësinë e padisë së begatimit, thjesht sepse shumë shpesh është e mundur të arrihet i njëjti rezultat i dobishëm përmes zbatimit të instituteve të tjera. Nëse efektivisht ekziston kjo mundësi zgjedhjeje, pranohet se, do t'i takojë të interesuarit të zgjedhë cila rrugë duket më oportune. Ndërkohë që, nëse në rastet në fjalë, nuk ka mjete të tjera, e vetmja mundësi do të jetë padia e begatimit. Kjo zgjidhje duket konform tendencave më të fundit doktrinale që janë shfaqur në këtë fushë. Për të mënjanuar keqkuptimet, duhet të theksohet që, rastet e vetme në të cilat shtrohet problemi i begatimit indirekt, janë ato në të cilat kontrata është specifikisht e finalizuar për të përmirësuar një send që i takon të tretit ose t'i sjellë një përfitim të natyrës personale, me shtesën e vetme të kontratave të lidhura nga një familjar për *necessaries*.

Në çdo rast, mund të veprohet kundër të tretit përfitues, vetëm kur personi i ndërmjetëm rezulton insolvabël dhe ndërkohë i treti akoma nuk ka derdhur ndonjë shumë për atë që ka marrë. Sidomos përse i takon përmirësimeve të tërthorta të sendit të tjetrit, duhet t'i jepet të tretit mundësia për të vepruar gjyqësisht direkt kundër pronarit, vetëm në rastet kur kjo nuk cënon parimet e shpallura për

begatimet e detyruara, d.m.th. çdo herë kur, pikërisht për të mbrojtur pronarin kundër vendosjes së përgjegjësisë nga begatimi, i hiqet mundësia edhe personit të ndërmjetëm për të vepruar gjyqësisht.

Si konkluzion, përsa kohë që, mundësia për padinë e begatimit në rastet e pasurimit *ex alieno contractu*, nuk përkthehet në një përdorim të tepruar të këtij mjeti, doktrina kontinentale nuk ka kundërshtime të veçanta për të pranuar parimisht mundësinë e përdorjes së kësaj padie. Ajo që gjithsesi duket e pamohueshme është që, përveç rasteve të transferimit falas (neni 822 BGB), rastet në të cilat mund të pranohet konkretisht mundësia e një padie direkte, shfaqen shumë të kufizuara.

Bibliografia

1. Kodi Civil i RSH 1994
2. Kodi i Familjes i RSH
3. Kodi Civil Italian
4. Kodi Civil Gjerman (BGB)
5. Jacques Ghestin, *Le contrat*, Paris 1980
6. Peter Birks, *An introduction to the Law of Restitution*, Oxford University Press, bot. 2, 1989
7. Andrew Tettenborn, *The law of restitution in England and Ireland*, bot. 3, Cavendish Publishing 2001
8. Alain Benabent, *Droit Civil, Les obligations*, Montchrestien 2003
9. Francesco Astone, *L'arricchimento senza causa*, Giuffrè 2000

Principal-Agent Relationship: How the Principal-Agent Tension Between Clients and Their Lawyers Affects Legal Negotiation

Armer Juka, LL.M.

The image of the lawyer in the public's perception has incessantly oscillated between two extremes. An idealistic vision has regarded the lawyer as a peacemaker whose mission is to discourage litigation and promote compromises¹. On the other end of the spectrum, the lawyer frequently came to be seen as a self-interested agent responsible for exacerbating disputes and preventing deals or making settlements costlier².

In the last decades, important research work has been dedicated to the study of negotiation. The two ground-breaking works in the field are *Getting to Yes*³ and *Barriers to Conflict Resolution*⁴. With few exceptions, this literature focused on principal-to-principal negotiation. This might strike one as surprising considering that negotiation through agents is ubiquitous.⁵

More recently, researchers have pondered over the role of agents in negotiation. They drew intensively from studies carried out in the field of principal-agent analysis within economics and transposed these findings to the negotiation framework.⁶ Using agents in negotiation creates an additional level of complexity: It provides advantages but with a price.

¹ *The Collected Works of Abraham Lincoln* edited by Roy P. Basler, Volume II, "Notes for a Law Lecture" (July 1, 1850), p. 81

² Rachel Croson and Robert H. Mnookin, 'Does Disputing through Agents Enhance Cooperation? Experimental Evidence' (1997) 26(2) *The Journal of Legal Studies* 331, 331.

³ Roger Fisher, William Ury and Bruce Patton, *Getting to Yes* (Third edition, RH Business Book, 2011)

⁴ Kenneth J. Arrow, Robert H. Mnookin, Lee Ross, Amos Tversky, Robert B. Wilson (eds), *Barriers to Conflict Resolution* (Norton 1995)

⁵ Robert H. Mnookin and Lawrence E. Susskind (eds), *Negotiating on behalf of others* (Saga publications, 1999) 2-3.

⁶ *Ibid*, 1-2.